Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-631
Datë: 25.06.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e III-t e mbajtur me datë 25.06.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet dhe validohet** "Qendra për Aftesim Profesional-Diamonds Profesional Academy", me adresë: Rr. "Aleks Caci", Uglar, Graçanicë, Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 25.06.2026 deri 25.06.2029, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

    1.1. **Edukimi Profesional për Kozmeticiente, Niveli IV i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK),** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 10 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Aftësimit Profesional për një vit kalendarik në total 12 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidate/nxënës për 1 grup mund të jetë maksimalisht deri 20 kandidate/nxënës, që në total bëjnë 240 kandidate/nxënës (20x12=240) kandidate/nxënës për një vit.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së "Qendra për Aftësim Profesional-Diamonds Profesional Academy" për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.